



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____._____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MOTORRA UJI PËR VARKAT”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT:CPV -Motorre per
levizjet detare ,42111100-1 ,CPV-Motorre 42111000-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 108 333(dy milion e njeqind e tete mije e treqind e tridhjetë e tre) leke pa tvsh nga e cila: 1 083 333(nje milion e tetedhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) leke pa tvsh nga grandit dhe 1 025 000 (nje milion e njezet e pese mije) leke pa tvsh nga te ardhurat.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, si edhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Divjakë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësisë e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter ehre vendosur bazuar ne Nenin 43 te VKM Nr.285/2021"Kerkesat per kapacitetet ekonomiko-financiare"pika 1 citon:*Autoriteti kontraktor , per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike ,kerkon kopje te deklaratave te xhiros vjetore te realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit te xhiros qe mbulon kontrata, per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre)vitet e fundit financiare, ndersa ne piken 2/c citohet : 40% te vleres se perlogaritur te kontrates ose lotit , ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar, dhe ne procedurat e prokurimit "Sherbim konsulence" , ndersa ne piken 3 citohet:Kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti /enti kontraktor .*

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte:

Vendosja e ketij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike , te cilet , nepermjete dokumentacionit te paraqitur duhet te vërtetojnë se zotërojnë kapacitete t e nevojshme , gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe bazuar ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë" i ndryshuar. si edhe ne Ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Mbi tatimin mbi te ardhurat ", i ndryshuar.Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori

ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten”

Në percaktimin e vlerës së xhiros, autoriteti kontraktor, është referuar në pikën 2, gërma c, të Nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik ofertues, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, detyrimet e maturuara për vitin 2023 dhe 2024 .

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të LPP-së, , i ndryshuar dhe në këto rregulla”, si edhe percaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me percaktimet e Ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 “ Per sistemin e taksave vendore” ,I ndryshuar ,sipas te cilit ,operoret ekonomike duhet te shlyejne detyrimet e taksave dhe tarifare vendore , ne cdo adrese ku ushtrojne aktivitet.

Përsa i perket aftesise teknike e profesionale , vleresojme si kriteret teknike te nevojshme , per tu permbushur nga operoret ekonomike pjesemarrres ne kete procedure prokurimi kriteret si me poshte:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme: Certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

(Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë)

Argumentimi: Në bazë të nenit 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar” dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, pasi blerja e këtij malli ka impakt mbi mjedisin, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Ky kriter është ne perputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku përcaktohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të

argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të cilës të deklarojë se , merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar në objekt pranë Bashkisë Divjake , sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklarate, se mallrat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se 2 vite, duke filluar nga momenti i furnizimit.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

SPECIFIKIMET TEKNIKE

*** Për 2 motorrët e ujit të varkave HP/Kw 15 kërkohen këto karakteristika teknike :**

• Fuqia e motorrit Hp/kw	15/11.1
• Tipi i motorrit	2 pistona ne linje (4 kohesh)
• RPM maksimale	6200 xhiro/min
• Vellimi i cilindrit	deri ne 335 cm ³
• Pesha e motorrit	deri ne 49 kg
• Lenda djegese	Benzine
• Sistemi i karburantit	injeksion
• Rezervuari i karburantit	12 litra
• Komandimi	Me doreze
• Ndezja	Manuale ,Elektrike
• Lëshimi	Elektrike

• Ftohtësi	Me uje
• Marshet	F-N-R (Para-Neutral-Indietro)
• Gjeneratori	12V/6A
• Dinamo/t	12 amp/147 watt ESM
• Gjatesia e kembes	M-15"/430 mm
• Raporti i transmisionit	2.15:1
• Viti I prodhimit jo me posht se	2020

-Gjatesia e timonit duhet te jete praktike dhe duhet te pozicionohet ne nje pozicion ideal per nje kontroll te sigurt.

-Dorezae komandes duhet te jete e madhe dhe komode.

-Suporti duhet te garantoje edhe paketimin e motorrit ne pozicionin vertikal ose te mundesoje pozicionimin ne toke ne krahun e pasem.

-Motorri duhet te jete i pajisur me pjese te cmontueshme lehte per te mundesuar heqjen e kriperave dhe mbetjeve te tjera nga percjellesit e ftohjes.

-Helika e motorrit duhet te jete e pozicionuar ne vend te mbrojtur per te mundesuar afrimin e mjeteve lundruese ne afersi te bregut pa e demtuar motorrin.

-Gjatesia e timonit duhet te jete praktike dhe duhet te pozicionohet ne nje pozicion ideal per nje kontroll te sigurt.

-Doreza e komandes duhet te jete e madhe dhe komode.

-Suporti duhet te garantoje edhe paketimin e motorrit ne pozicionin vertikal ose te mundesoje pozicionimin ne toke ne krahun e pasem.

-Motorri duhet te jete i pajisur me pjese te cmontueshme lehte per te mundesuar heqjen e kriperave dhe mbetjeve te tjera nga percjellesit e ftohjes.

-Helika e motorrit duhet te jete e pozicionuar ne vend te mbrojtur per te mundesuar afrimin e mjeteve lundruese ne afersi te bregut pa e demtuar motorrin.

- Dy motorret e kerkuar duhet te jene kembeshkurter.

-Motorret e ujit duhet te jene te thjeshte per tu perdorur ,pa zhurme ,te thjeshte ne montim dhe te garantoje nje kend perkulje te kenaqshem.

-Motorri duhet te siguroje ecjen ne pozicionet para-neutral-indietro dhe te jete i pajisur me tregues se gjendjes se baterise.

-Kemba duhet te jete prej materiali te pakonsumueshem kunder ndryshkjes dhe thyerjes.

-Motorri duhet te jete 12V me magnet te perhershem dhe me helike qe te jete rezistente nga algat.

-Fituesei duhet te pergjigjet per nje periudhe 2-vjecare per te gjitha difektet e mundshme dhe sherbimet qe mund te lind nevoja per tju bere motorrave te ujit.

*** Për 3 motorrët e ujit të varkave HP/Kw 20 kërkohen këto karakteristika teknike :**

• Fuqia e motorrit Hp/kw	20/14.7
• Tipi i motorrit	2 pistonave ne linje (4 kohesh)
• RPM maksimale	6200 xhiro/min
• Vellimi i cilindrit	deri ne 335 cm ³
• Pesha e motorrit	deri ne 49 kg
• Lenda djegese	Benzine
• Sistemi i karburantit	injeksion
• Rezervuari i karburantit	12 litra
• Komandimi	Me doreze
• Ndezja	Manuale ,Elektrike
• Leshimi	Elektrike
• Ftohtesi	Me uje
• Marshet	F-N-R (Para-Neutral-Indietro)
• Gjeneratori	12V/6A
• Dinamo/t	12 amp/147 watt ESM
• Gjatesia e kembes	M-15"/430 mm
• Raporti i transmisionit	2.15:1
• Viti I prodhimit jo me posht se	2020

***3 motorret e kerkuar duhet te jene kembeshkurter.**

- Motorret e ujit duhet te jene te thjeshte per tu perdorur ,pa zhurme ,te thjeshte ne montim dhe te garantoje nje kend perkulje te kenaqshem.
- Motorri duhet te siguroje ecjen ne pozicionet para-neutral-indietro dhe te jete i pajisur me tregues se gjendjes se baterise.
- Kemba duhet te jete prej materiali te pakonsumueshem kunder ndryshkjes dhe thyerjes.
- Motorri duhet te jete 12V me magnet te perhershem dhe me helike qe te jete rezistente nga algat.
- Fituesei duhet te pergjigjet per nje periudhe 2 vjecare per te gjitha difektet e mundshme dhe sherbimet qe mund te lind nevoja per tju bere motorrave te ujit.
- Motorrët qe kërkohen të jene me një garanci deri në 2 (dy) vite .

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushes , duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor , ne perputhje me percaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar , e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar , Neni 12 , Neni 13 dhe Neni 76.

*** Shënim: Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**